




# Vlerësimi i mundësive të biznesit drejt modelit të ekonomisë qarkulluese

Circular Economy Toolkit- Universiteti i Kembrixhit. Përshtatur nga Qendra për Aftësi Konkurruese

Ky dokument është mundësuar nga mbështetja financiare e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Aftësi Konkurruese (Center for Competitive Skills), dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rrethanë se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.

# Programi i Workshop-it




Hyrje në Ekonominë Qarkulluese	10 min
Objektivat e sesionit	5 min
Pamje e përgjithshme e mundësive	5 min
Diskutim i thelluar i mundësive - fletë pune	80 min
Mundësitë e realizueshme	10 min
Hapat e radhës	10 min
	<b>2 orë</b>

# EKONOMIA QARKULLUESE

## Një model alternativ i rritjes për një të ardhme të qëndrueshme

Praktikat e vendosura ekonomike, prodhimi, konsumi dhe zhvillimi industrial, mbizotërohen nga procesi linear, i trashëguar nga modeli i rritjes industriale të pasluftës "merr-përdor-hidh". Në fakt, ky është nocioni dritëshkurtër i rritjes, që rrezikon mjaftueshmërinë e burimeve të tokës në të ardhmen e afërt, si dhe shkakton kosto të mëdha për mjedisin, përmes prodhimit të madh të mbetjeve dhe lëshimit të gazeve serë. Për këtë qëllim, është thelbësore të shkohet drejt një modeli alternativ që mund të ulë rrezikun e mungesës së burimeve, duke iu përgjigjur sfidave të klimës, siç premtohet nga modeli i Ekonomisë Qarkulluese (EQ). Megjithatë, kalimi në një EQ mund të konceptohet vetëm në kushtet e një ndryshimi sistemik, që kërkon ndryshime në fushën ekonomike, politike dhe socio-kulturore.



## EKONOMIA QARKULLUESE - 3 pyetjet dhe 3 parimet kryesore

Po sikur mbeturinat dhe ndotja të mos ishin krijuar kurrë si fillim?

### Parimi 1 - PROJEKTIMI I SISTEMEVE DHE MODELEVE PA MBETJE DHE NDOTJE

Ekonomia qarkulluese nxjerr në pah dhe projektton sisteme e modele duke eliminuar ndikimet negative të aktivitetit ekonomik, që dëmton shëndetin e njerëzve dhe sistemet natyrore. Kjo përfshin çlirimin e gazrave dhe substancave të dëmshme, ndotjen e ajrit, tokës dhe ujit, si dhe mbetjet strukturore, siç mund të jetë bllokimi i trafikut.

Po sikur të ndërtojmë një ekonomi që i përdor gjërat, në vend që t' i konsumojë ato?

### Parimi 2 - MBAJTJA E PRODUKTEVE DHE MATERIALEVE NË PËRDORIM TË VAZHDUESHËM


Ekonomia qarkulluese përkrah aktivitetet që e ruajnë vlerën në formën e energjisë, punës apo materialit. Kjo nënkupton projektimin për qëndrueshmëri, ripërdorim, riprodhim dhe riciklim, për t' i mbajtur produktet, pjesët përbërëse dhe materialet të qarkullueshme në ekonomi. Sistemet qarkulluese përdorin me efektivitet materialet me bazë biologjike, duke nxitur përdorimin e tyre në mënyra të ndryshme, ndërsa ato kalojnë kalonë me cikle ndërmjet ekonomisë dhe sistemeve natyrore.

Po sikur, jo vetëm ta mbrojmë, por ta përmirësojmë aktivisht mjedisin?

### Parimi 3- RIGJENERIMI I SISTEMEVE NATYRORE

Ekonomia qarkulluese shmanë përdorimin e burimeve të paripërtëritshme, dhe i ruan apo shton ato të ripërtëritshme, për shembull, duke i rikthyer tokës lëndë ushqyese që mbështesin ripërtëritjen, apo duke përdorur energji të rinovueshme në vend të mbetjeve fosile.

# Ekonomia Qarkulluese




**Kursimi neto nga kosto e materialeve llogaritet rreth \$ 340 – 380 mld ne vit ne BE dhe \$2 Trilion ne ekonomine boterore \*sipas Ellen MacArthur Foundation**

# Diagrama Flutur e Ekonomisë Qarkulluese



QARKONOMIA  
Platforma e Ekonomisë Qarkulluese në Shqipëri



1. Gjuetia dhe peshkimi
2. Si lëndë e parë mund të shërbejnë si mbetjet pas korrijeve, edhe mbetjet pas konsumit.

**BURIMI:**  
Fondacioni Ellen MacArthur  
Diagrama e sistemeve të Ekonomisë Qarkulluese (shkurt 2019)  
[www.ellenmacarthurfoundation.org](http://www.ellenmacarthurfoundation.org)


Publikuar me Lejen e Fonadacionit Ellen MacArthur  
Përkthimi jozyrtar në shqip nga Center for Competitive Skills



# Objektivat e Workshopit

- Arritja e një kuptimi të përbashkët mbi Ekonominë Qarkulluese
- Njohja me mundësitë dhe përfitimet që sjell për biznesin Ekonomia Qarkulluese, si dhe pengesat
- Njohja dhe praktika me instrumentet për vlerësimin e potencialit të biznesit drejt Ekonomisë Qarkulluese

# Mundësitë për ekonominë qarkulluese



# Pakësimi i materialeve

## Dizenjimi, Prodhimi dhe Shpërndarja

Pakësimi i materialit të përdorur, ose dematerializimi, nënkupton përdorimin e sa më pak materiali të jetë e mundur. përmes zvogëlimit, lehtësimit të peshës, ose kalimit të shërbimeve nga fizike në digjitale.

Kjo është e mundur si për **produktet** edhe për **paketimin**

### Përfitimet

- Ulje e kostos për lëndët e para
- Kosto më të ulëta shpërndarjeje
- Më pak hapësirë e nevojshme për magazinim
- Mundësi kursimi edhe për klientin

### Për t'u patur parasysh

- Mund të ulet qëndrueshmëria e produktit / paketimit
- Ndryshimi në materiale mund të sjellë ndryshime të kostos së materialeve

### Raste studimi



# Optimizimi i materialeve

## Dizenjimi, Prodhimi dhe Shpërndarja

Përzgjedhja e materialeve më të mira për të siguruar një zinxhir të qëndrueshëm vlerash:

1. Lëndë ushqyese biologjike në vend të atyre teknike
2. Përdorimi i materialeve të ricikluara
3. Pakësim i materialeve të rralla apo të kufizuara në sasi
4. Heqja e substancave toksike
5. Materiale me emetim më të ulët të karbonit (p.sh. plastika në vend të çelikut)

### Përfitimet

- Pakësim i materialeve me lëndë të para të virgjëra
- Reputacion i mirë
- Përfitime financiare
- Pakësim i materialeve të hedhura në landfill
- Më pak emetime gazrash dhe ndotje

### Për t'u patur parasysh

- Mund të ulët qëndrueshmëria e produktit / paketimit
- Ndryshimi në materiale mund të sjellë ndryshime të kostos së materialeve

### Raste studimi

1)

2)

3)

# Simbioza Industriale / Riciklimi

## Dizenjimi, Prodhimi dhe Shpërndarja

Simbioza industriale është shkëmbimi fizik i materialeve ose energjisë midis kompanive; mbeturinat nga një kompani bëhen burim për një kompani tjetër. Materialet përfshijnë ujë, nxehtësi, avull, hi, letër, tallash, karton, vaj, minerale, metale, etj.

### Përfitimet

- Gjeneroni para nga mbetjet ose blini më lirë
- Përmirësim i marrëdhënieve me të tjerët
- Pakësohet përdorimi i përgjithshëm i burimeve, mbeturinat dhe emetimet


### Për t'u patur parasysh

- Gjetja e palëve të tjera për të punuar
- Cilësia e prurjeve / furnizimit
- Ndarja e njohurive për rrjedhat e mbetjeve
- Rregullat/ ligjet për transportimin e materialeve të rrezikshme

### Raste studimi

# Cikli i jetës

Qëllimi i kësaj strategjie është të zgjasë jetën e produktit dhe të përmirësojë efikasitetin e produktit për konsumin e burimeve. Sidoqoftë, nëse produkti konsumon burime, jetëgjatësia e produktit duhet të përputhet me efikasitetin e produktit.



## Përfitimet

- Ulet kostoja totale e pronësisë
- Ul ndikimin e përgjithshëm në mjedis

## Për t'u patur parasysh

- Mund të kanibalizojë shitjet
- Jetëgjatësia e produktit e përcaktuar nga përdoruesi, p.sh. ndryshimi i modës
- Kërkohe investim për të bërë ndryshimin

## Dizenjimi i produktit

- I besueshëm
- Efikasitet i lartë i burimeve
- Cilësi e lartë

## Raste Studimi

# Mirëmbajtja / Riparimi

Mirëmbajtja / Riparimi është një aktivitet kritik që kryhet në fazën e përdorimit, për të zgjatur kohën e funksionimit të sistemeve. Ofertat e mirëmbajtjes mund të përfshijnë:

- Riparime
- Shërbime
- Diagnostikime – në vend ose *remote*
- Suport Teknik
- Instalime
- Garanci

## Përfitimet

- Zgjat jetën për klientin
- Mënyra më efikase për kthimin e sistemit në gjendje pune
- Burim i përparësisë konkurruese
- Mund të gjenerojë 3-4 herë më shumë qarkullim sesa blerja fillestare

## Për t'u patur parasysh

- Shërbimi ndaj klientit është thelbësor
- Konkurrenca
- Cilësia e riparimit
- Kostoja e riparimit
- Shpejtësia e riparimit
- Mund të kërkohet teknologjia e fundit

# Mirëmbajtja / Riparimi

## Dizenjimi i produktit

- Akses i thjeshtë në pjesët e këmbimit
- Diagnostikimi i defekteve
- Trajtimi dhe montimi i pjesëve
- Shkëmbimi i ndërsjelltë i pjesëve
- Akses në pikat e vajosjes
- Vecori /funsione të panevojshme
- Rregullimet përfundimtare
- Identifikimi i komponentëve
- Lidhje elektrike të reduktuara
- Siguria për teknikët

## Raste Studimi

# Ripërdorimi / Rishpërndarja / Rishitja

Ri-përdorimi dytësor i drejtpërdrejtë ose rishitja e zgjat jetën e produktit përmes përdorimit të dorës së dytë. Produktet e rishitura mund të jenë produktet e plota ose komponentet e produktit. Shërbimet shtesë mund të përfshijnë testimin dhe çertifikimin dhe rilëshimin e garancisë.

## Përfitimet

- Të ardhura shtesë që aktualisht merren nga të tjerët
- Aftësia për të ofruar përditësime dhe për të përmirësuar marrëdhëniet me klientët
- Parandalon materiale dhe energji të mëtejshme që do të përdoren për produktet e reja

## Për t'u patur parasysh

- Vëllimi i furnizimit
- Vëllimi i kërkesës
- Cilësia dhe reputacioni i kompanisë
- Transparenca e çmimeve
- Çmimi konkurrues
- Konkurrenca

## Dizenjimi i Produktit

Çdo produkt i qëndrueshëm i cili ende ka vlerë pasi klienti dëshiron ta ndryshojë/të mos e përdorë atë


## Raste Studimi

# Rinovimi / Riprodhimi

Procesi i marrjes së produkteve të përdorura të referuara si 'bërthama' dhe rikthimi i cilësisë dhe / ose estetikës së tyre:

- Riprodhimi - Kthim i produktit në specifikimet fillestare
- Rinovimi - Produkt vjen 'si i ri', me cilësi dhe / ose estetikë të përmirësuar

Procesi i grumbullimit



# Rinovimi / Riprodhimi

## Përfitimet

- Riprodhimi mund të jetë dy herë më fitimprurës se prodhimi (Steinhilper, 2006)
- Kredencialet e gjelbërta
- Pakësim i energjisë, materialeve dhe mbetjeve

## Për t'u patur parasysh

- Çmimi konkurrues për klientin
- Furnizimi dhe cilësia e bërthamës
- Cilësia e pjesëve të rinovuara / riprodhuara
- Ndryshimet në bërthama

## Dizenjimi i produktit

- Lehtësia e çmontimit
- Numri i lidhjeve
- Mjetet e nevojshme për çmontim
- Dëmi i shkaktuar gjatë çmontimit
- Lehtësia e montimit
- Lehtësia e identifikimit
- Potenciali për përmirësim (*upgrade*)
- Modulariteti i pjesëve

## Raste Studimi



# Riciklimi i produktit

Riciklimi është procesi i përdorimit të materialeve në fund të jetës së tyre, për të prodhuar produkte të reja. Produktet duhet të projektohen për të siguruar që materialet të ndahen dhe të ripërdoren në fund të jetës së tyre të dobishme.

## Përfitimet

- Reduktimi i mbetjeve që shkojnë në *landfill*
- Kursen dhe zgjat jetën e burimeve natyrore
- Reduktimi i nxjerrjes së materialit të virgjër
- Pajtueshmëria me legjislacionin

## Për t'u patur parasysh

- Kërkesat ligjore
- Kostoja e ndryshimit të dizajnit
- Ridizenjimi mund të ndikojë në funksionalitetin e produktit

## Dizenjimi i produktit

- Minimizimi i vëllimit të mbetjeve
- Reduktimi i spektrit të materialeve
- Përdorimi i materialeve të riciklueshme
- Pak kombinime materialesh
- Toksiciteti

## Raste studimi

# Produktet si Shërbim

Në vend të shitjes konvencionale të produkteve, është e mundur ta ofroni produktin si një shërbim. Ofruesi zakonisht e zotëron produktin gjatë gjithë ciklit të jetës dhe mund ta menaxhojë atë përmes dizenjimit, përdorimit, mirëmbajtjes, ripërdorimit, riprodhimit dhe riciklimit.

## Lloje të produkteve si shërbim:

- Paguaj për njësi shërbimi: klienti paguan sa herë që përdor shërbimin (psh. gomat e makinës për km, apo fotokopja per faqe.)
- Marrja me qira e produktit: klienti paguan për të përdorur produktin, normalisht për një periudhë të shkurtër kohe (makina me qira)
- Qira Produkti: klienti ka qasje të vazhdueshme në produkt, zakonisht për një periudhë më të gjatë kohore
- *Product Pooling*: kur shumë klientë mund ta përdorin produktin njëkohësisht

# Produktet si Shërbim

## Përfitimet

- Përmbush më mirë nevojat e klientëve
- Ndërton marrëdhënie më të mira me klientët
- Përshpëjtim i risive
- Pengesa më të ulta për hyrjen e klientit pasi nuk ka nevojë të blejë
- Reduktim i lëndëve të para, energjisë dhe mbetjeve

## Për t'u patur parasysh

- Mospërgjigja në kohën ose cilësinë e dakortësuar
- Investime për krijimin e shërbimit dhe ruajtjen e pronësisë
- Duhet të menaxhohen fushat e reja të zinxhirit të vlerës
- Përdorimi i papërgjegjshëm i produkteve që çon në dëmtime

## Dizenjimi i produktit

Duhet të merrni parasysh për çdo cikël jete:

- Përdorimi
- Mirëmbajtja / Riparimet
- Rinovimi / riprodhimi
- Riciklmi

## Raste Studimi

## FLETË PUNE

# VLERËSOJMË MUNDËSITË PËR TË QENË QARKULLUES



A4

Mundësia që produkti, shërbimi ose organizata/biznesi juaj të bëhet më qarkullues mund të fillojë me hapa të vegjël. Merrni parasysh ata faktorë mbi të cilët keni ndikim të drejtpërdrejtë dhe filloni aty. Ndërkohë që bëni përparime të vogla, mbajini sytë tek objektivi më i madh, duke i përshkallëzuar arritjet dhe zgjidhjet tuaja me kalimin e kohës.

## HAPAT

- 1 Filloni duke zgjedhur një produkt, shërbim ose një sfidë biznesi ku do të përqëndroheni.
- 2 Përdorni fletën e punës në vijim 'Eksplorojmë mundësitë për të qenë qarkullues'. Filloni duke shkruar çfarë zgjidhje ofron produkti apo shërbimi juaj.
- 3 Shqyrtoni pyetjet për të eksploruar mundësi të për të qenë qarkullues . Nëse i përgjigjeni 'po' ndonjë prej pyetjeve, shënoni gjërat që duhen patur parasysh për secilën mundësi që ekziston brenda organizatës /biznesit tuaj .
- 4 Bazuar në konsideratat për secilën, a dallon ndonjë nga mundësitë si pikënisje e mirë? Cilën mundësi e ndjeni të arritshme menjëherë, me potencial për të përmirësuar vlerën e klientit dhe biznesit? Mund të jetë me dobi të merrni dhe mendimin e të tjerëve brenda organizatës/biznesit, për të vendosur mbi mundësinë që do të ndiqni.
- 5 Duke përdorur faqen e dytë, krijoni një skicë për atë që mund të ndiqni, duke i bërë vetes pyetjet e mëposhtme:
  - A do ta përmirësonte kjo risi përvojën e klientit në ndonjë mënyrë?
  - Çfarë do të kërkonte ky sistem që nuk ekziston aktualisht?
  - Si mund të ndikojë kjo në strategjinë tuaj të biznesit dhe nevojat financiare?
  - Çfarë roli i ri apo bashkëpunimi mund t'ju nevojitet për realizimin e kësaj inisiative?
  - Cili është hapi i radhës për të filluar këtë proces?
- 6 Si hapa të radhës mund të përcaktoni sfidën, e më tej të krijoni një Model Biznesi Qarkullues si dhe të Fitoni Përkrahje brenda organizatës/biznesit për t'u bërë qarkullues.

## FLETË PUNE

# VLERËSOJMË MUNDËSITË PËR TË QENË QARKULLUES



A4

Shikoni për mundësitë që të bëheni më qarkullues. Përgjigjuni të gjitha pyetjeve të mëposhtme. Mbani parasysh nevojat bazë që zgjidh oferta juaj.

ZGJATJA E JETËS SË PRODUKTEVE	PO	JO	PËR T'U PATUR NË KONSIDERATË
A ka ndonjë mënyrë/mundësi që produkti juaj të kthehet në shërbim?			
A mund ta bëni më të lehtë për përdoruesit që t'i riparojnë vetë produktet tuaja?			
A mund ta projektoni produktin tuaj që të jetë më modular, që pjesët individualë të zëvendësohen më lehtë?			
A mund të ofroni një shërbim mirëmbajtjeje për të ruajtur jetën e produktit?			
A mund të punoni direkt me prodhuesin tuaj për të kthyer produktet tuaja pas ciklit të parë të përdorimit të tyre?			

INPUTE DHE OUTPUTE ME QËLLIM QARKULLUES	PO	JO	PËR T'U PATUR NË KONSIDERATË
A mund të përdorni mbetje ose materialet e ricikluara për materialet tuaja?			
A mund të sigurohet/blihet ndonjë nga materialet tuaja më shumë në vend/lokalisht?			
A mundet që prodhimi juaj të lokalizohet më shumë?			
A mund të minimizoni rrjedhën e mbetjeve që prodhon produkti juaj?			
A mundet që produkti juaj të kontribuojë në një cikël biologjik në një farë mënyre?			

FLETË PUNE

# VLERËSOJMË MUNDËSITË PËR TË QENË QARKULLUES




Zgjidh njërën nga mundësitë e identifikuara në fletën e mëparshme, dhe paraqite këtu.

**MUNDËSIA IME PËR TË QENË QARKULLUES ËSHTË:**



**A DO TË SJELLË KJO RISI NDONJË PËRMIRËSIM NË PËRVOJËN E KONSUMATORIT?**

**ÇFARË KËRKOHEM NGA SISTEMI I RI, QË AKTUALISHT NUK EKZISTON?**



**ÇFARË NDIKIMI MUND TË KETË KJO NË STRATEGJINË DHE NEVOJËN FINANCIARE TË BIZNESIT?**




**ÇFARË ROLI I RI APO BASHKËPUNIMI MUND T'JU NEVOJITET PËR REALIZIMIN E KËSAJ INISIATIVE?**



**CILI ËSHTË HAPI I RADHËS PËR TË FILLUAR KËTË PROÇES?**



# Caktimi i përparësive



# Hapat e radhës



**Ju faleminderit!**